

EFFECTS OF DIVORCE ON CHILDREN. EXPERIENCING ANXIETY EFEKTET E DIVORCIT TEK FËMIJËT SHQIPTARË. PËRJETIMI I ANKTHIT

VALBONA TRESKA
valbonatreska@yahoo.com

AKTET VI, 1: 276-281, 2013

PËRMBLEDHJE

Gjatë eksperiencës si psikologe ligjore, kam vlerësuar se përjetimi i divorcit nga fëmijët, mënyra e reagimit të prindërve, si dhe e gjithë situata e krijuar në familjen biologjike, ndikojnë dukshëm ankthin e përjetuar prej tyre. Ky punim kërkon të sjellë në vëmendje dhe të hedh dritë mbi format e divorcimit të çifteve në Shqipëri që çojnë në përjetim më të lartë të nivelit të ankthit tek fëmijët e tyre, faktorët që ndikojnë tek përjetim i ankthit si dhe qëndrimet dhe sjelljet që prindërit në divorc duhet të mbajnë për të minimizuar këtë ankth të përjetuar.

Fjalët kyç: divorc, efekte, fëmijë, ankth, shqiptarë

SUMMARY

During my experience as a legal psychologist, I estimated that the experience of parents divorce from the children, the way parents react, as well as the entire situation in biological family, significantly affect anxiety experienced by them. This paper seeks to bring to attention the forms of divorcing couples in Albania that lead to higher level of anxiety experience from their children, the factors that affect anxiety, as well as attitudes and behaviors that divorce parents should keep to minimize this anxiety experienced.

Key words: divorce, child, effects, anxiety, Albanian.

HYRJE

Fëmijët e sotëm janë shumë më të ekspozuar dhe riskuar nga problemet në familje dhe divorci sesa disa dekada më parë.

Studimet tregojnë se shumë nga problemet e përjetuara sot mund të vijnë gjithashtu si pasojë e ndryshimeve dhe transformimeve të dinamikës së familjes në shoqëri. (Vandwater & Lansford, 1998; Yongmin, 2001; Dykeman, 2003).

Në një studim të 2002 në Sh.B.A, Jeynes raporton se nga 50-60% e fëmijëve jetojnë në shtëpi vetëm me njërin prind gjatë fëmijërisë së tyre.

Duke mbajtur parasysh rritjen e numrit të divorceve në Shqipëri e duke iu referuar këtij autori, përfshirja e prindërve, mbikqyrja dhe kujdesi i prindërve ndaj fëmijëve të tyre shpesh bie për shkak të divorcit.

Studime të mëparshme në këtë fushë, por vecanërisht puna e përditshme me divorcet,

tregojnë se fëmijët përjetojnë në mënyra të ndryshme konfliktet në familje dhe më pas ndryshimin e strukturës familjare. Po kështu vërehet të ketë një lidhje të fortë mes mirëqënies emocionale të fëmijëve dhe strukturës së familjes ku ata jetojnë.

Shpesh çiftet udhëhiqen nga idea se është më mirë që një fëmijë të rritet vetëm me njërin prind në shtëpi, sesa të vuaj vazhdimisht konfliktet e prindërve të cilët nuk vendosin të divorcohen. Gjithsesi, sido që bashkëshortët të vendosin të jetojnë apo të mos jetojnë më sëbashku, kjo është një situatë që ndikon detyrimisht fëmijët.

Vetëm në periudhën janar-gusht 2012 janë regjistruar 1318 kërkesa për zgjidhje martesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pjesa dërrmuese e të cilëve janë çifte me fëmijë të mitur. Kjo do të thotë se në 6 mujorin e parë të vitit, të paktën 1000 fëmijë kanë qenë të gjendur

përpara faktit se duhet të jetojnë vetëm me njërin prind pas divorcit.

Punimi që do të paraqitet në vazhdim merr të mirëqenë përjetimin e lartë të ankthit tek fëmijët e çifteve në divorc. Bazuar në studime të mëparshme të dekadave të fundit del qartë në pah se, fëmijët që jetojnë vetëm me njërin prind për shkak të divorcit, përjetojnë nivel më të lartë ankthi dhe depresioni se fëmijët e familjeve solide. Ata kanë më pak shokë dhe nuk përfshihen në aktivitete sociale njësoj me bashkëmoshatarët e tjerë.

Kristiana 11 vjeç po përjetonte konfliktin mes prindërve prej rreth 4 vitesh. Bashkëshortët ishin veçuar e ribashkuar disa herë deri në veçimin përfundimtar të tyre dhe vendimit të nënës për zgjidhje martesë. Pas largimit të saj nga banesa Kristiana kishte vijuar të qëndronte me të atin. Gjatë periudhës së proceduarave për divorc vajza shmangte kategorikisht çdo kontakt me nënën. E gjendur përpara faktit se ishte nëna ajo që u largua nga banesa, nën presionin e një alienimi të rëndë prindëror nga i ati, si dhe gjendur përpara një mjedisi social që vlerëson ende tadu divorcin, vajza shfaqte shenja të theksuara të ankthit. Ajo kishte pësuar rënie të dukshme në mësimet si dhe ishte izoluar nga të gjitha aktivitetet sociale me bashkëmoshatarët. Kristiana frekuentonte jo rregullisht shkollën dhe parapëlqente të qëndronte vetëm në bankë gjatë mësimet. Ajo kishte somatizuar gjendjen e saj psikologjike në dhimbje të forta koke.

Raste si i Kristianës ndeshen shpesh gjatë periudhave të divorcit mes çifteve. Ndonëse situatat konfliktuale në familje kanë qenë të zgjatura në kohë përpara vendimit për divorc, ajo ç'ka vërehet është se vetë periudha e procesit të divorcit vlerësohet të jetë kulmi i konflikteve dhe mosbashkëpunimit në afër 70% të rasteve të divorcit.

Stresi dhe ankthi i përjetuar nga fëmijët e këtyre çifteve ndikohet gjithashtu nga fakti se vetë periudha e divorcit ligjor zgjat mesatarisht 7 muaj në Gjykatën e Shkallës së parë, ndërkohë që mund të shkojë edhe deri në disa vite duke përfshirë të gjitha shkallët e gjyqimit.

Kjo do të thotë se fëmijët e këtyre çifteve gjenden në një situatë të pastabilizuar familjare, ekonomike e sociale gjatë kësaj periudhe, ç'ka ndikon dukshëm mirëqenien e tyre psikologjike.

QËLLIMI I STUDIMIT

Punimi synon t'i japë përgjigje tre pyetjeve kryesore. Konkretisht:

1. Cilat forma të divorcit çojnë në përjetim më të lartë të ankthit nga fëmijët e prindërve në divorc?
2. Cilët janë faktorët që ndikojnë tek ankthi i përjetuar nga këta fëmijë?
3. Cilat janë qëndrimet dhe sjelljet që prindërit në divorc duhet të mbajnë për të minimizuar nivelin e ankthit tek fëmijët e tyre?

METODOLOGJIA DHE KAMPIONI

Studimi do të ndërthurë tre metoda kryesore:

1. Intervistave të thëlluara individuale me çiftet në proces divorci dhe fëmijët e tyre.
2. Pyetësorë
3. Vëzhgime

Për të patur informacion sa më të plotë në lidhje me çiftin në divorc, është parë gjithashtu me interes studim i materialit dokumentar (dosjeve gjyqësore) përfshi vlerësimin psikologjik të realizuar nga eksperti psikolog me kërkesë të gjykatës për palët në proces.

Në studim përfshihen 50 çifte në proces divorci dhe fëmijët e tyre të mitur. Studimi është kryer në Gjykatën e Tiranës në periudhën janar 2012-prill 2012.

Përzgjedhja e çifteve është bërë në mënyrë rastësore, duke mbajtur parasysh që bashkëshortët të ishin prindër të fëmijëve të mitur të përfshirë gjithashtu në divorc. Kampioni ka patur elementë të përbashkët fëmijët e mitur nga 6-16 vjeç.

Nga 50 çiftet e marrë në studim, 23 prej tyre kishin vetëm 1 fëmijë, 26 kishin dy fëmijë të mitur dhe një çift kishte tre fëmijë të mitur. Në total studimi bazohet në 78 fëmijë me prindër në proces divorci.

REZULTATET

Sjell në vëmendje se fëmijët me prindër në proces divorci, apo me prindër të divorcuar,

përjetojnë forma ankthi të cilat mund të variojnë në kohë dhe formë. Sikundër u theksua më sipër, niveli i ankthit të përjetuar është një ndërthurje e gjerë e një sërë faktorësh që ndikojnë tek vetë fëmija.

Nisur nga ekspserinca e përditshme dhe puna me këta fëmijë, si dhe nga rezultat e studimeve të tjera të realizuara, del në pah natyra konfliktuale e zgjidhjes së divorceve në vendin tonë. Konkretisht në studimin e realizuar në vitin 2011 në lidhje me tendencat e divorceve, rezultoi se 69.2% e divorceve me kërkesë padi klasifikohen si divorce konfliktuale dhe të dhunshme. (*V. Treska, Referuar në Konferencën e Prishtinës 2011 organizuar nga Alb Shkenca*).

Bazuar në këtë shifër natyrshëm lind pyetja:

1. Cilat forma të divorcit çojnë në përjetim më të lartë të ankthit nga fëmijët e prindërve në divorc?

Fëmijët e marrë në studim i përkisnin grupmoshës 6-16 vjeç. Ata u kategorizuan në dy grupe:

a. 55 fëmijë të çifteve në proces divorci konfliktual dhe të dhunshëm.

b. 23 fëmijë të çifteve në proces divorci jo konfliktual ku prindërit vazhdojnë të kenë bashkëpunim për fëmijët.

Rezultatet e përfuara vërtetuan se fëmijët e çifteve në divorce konfliktuale shfaqin nivel më të lartë ankthi se fëmijët e çifteve në një proces më të qetë divorci.

Kështu: 45 fëmijë apo 81.8% të kategorisë me prindër në konflikt, sëbashku me prindërit e tyre, raportuan se, kishin patur rënie të dukshme në mësim gjatë periudhës së divorcit mes prindërve.

Vetëm 5 fëmijë ose 21.7% të çifteve në proces divorci jo konfliktual raportuan se kishin patur rënie të dukshme në mësim gjatë kësaj periudhe.

Ana 15 vjeç raportoi se kishte humbur një vit shkollor për shkak të problemeve që prindërit kishin patur gjatë kësaj kohe.

Raste të tilla të ngjashme u raportuan edhe nga 6 fëmijë të tjerë gjatë realizimit të këtij studimi.

Në 55 fëmijët e kategorisë me prindër në konflikt gjatë periudhës së divorcit, 42 prej tyre ose

76.3% raportuan se nuk arrinin të përqëndroheshin në realizimin e detyrave. Në intervistat individuale ata raportuan gjithashtu se nuk arrinin të përqëndroheshin as në një emision televiziv që më parë i tërhiqte. Pjesa tjetër e fëmijëve raportuan se përqëndroheshin me vështirësi në realizimin e detyrave.

Kundrejt këtij rezultati, 6 fëmijë ose 26.0% me prindër jo në proces divorci konfliktual, raportuan se hasnin vështirësi në përqëndrim gjatë realizimit të detyrave.

Kristi 10.5 vjeç pohoi gjatë intervistës individuale se vetëm i mbante librat hapur, por nuk arrinte të lexonte asgjë në to. *“Edhe në klasë kështu më ndodh. E shoh zyshën në sy, por as e kam mendjen fare...mendoj vetëm për sherret mes mamit e babit...Mezi po pres sa të mbarojë...! (zgjidhja e martesës).*

39 nga 55 fëmijët me prindër në konflikt u raportuan se shfaqnin nervozizëm dhe ishin të irrituar më shumë se më parë. Ndërsa për 14 prej tyre u raportua se shfaqeshin të tërhequr e të heshtur.

Në grupin e fëmijëve me prindër në divorc jo konfliktual për 4 prej tyre u raportua se shfaqnin nervozizëm dhe ishin më të irrituar se më parë.

Puna me fëmijët në proces divorci të prindërve ka treguar gjithashtu se, një pjesë e mirë e tyre shfaqin gjithashtu ankthin e përjetuar duke u shkëputur e tërhequr nga shoqëria apo aktivitetet sociale. Shumë prej tyre humbasin dëshirën për të qenë pjesë e aktiviteteve të klasës.

Përpunimi i të dhënave të fëmijëve të cilët u bënë pjesë e këtij punimi, nxorri në pah se:

31 e fëmijëve me prindër në konflikt ose 56.3% kishin modifikuar sjelljen e tyre kundrejt bashkëmoshtarëve duke qenë më të tërhequr nga aktivitetet e organizuara sëbashku.

18 ose 32.7% prej tyre i ishin rikthyer të fjeturit sëbashku me njërin prind, kryesisht me nënën. Këta fëmijë varionin nga mosha 6-13 vjeç.

Të dhënat e këtyre elementeve tek grupi i fëmijëve me prindër në divorc jo në konflikt ishin mjaft të ulta me 8.69%. Vetëm për 2 fëmijë u

raportua se kishin ndryshuar mënyrën e të fjeturit duke u rikthyer të flenë me njërin prind.

Nga të dhënat e gjeneruara më sipër vërehet se ka një korrelacion të drejtë mes konflikteve në familje dhe simptomave të ankthit të shfaqura tek fëmijët e këtyre çifteve. Vërehet gjithashtu se sa më i fortë të jetë konflikti, aq më shumë elementë të ankthit e diskomfortit emocional shfaqin fëmijët.

2. Cilët faktorë ndikojnë në përjetimin e ankthit tek këta fëmijë?

Ka një sërë faktorësh që ndikojnë tek përjetimi i ankthit nga fëmijët me prindër në proces divorci. Literatura botërore dhe studimet e ndërmarra në vende të tjera rendisin gjithashtu një mori arsyesh lidhur me këtë çështje. Faktorë të tillë si mosha e fëmijës, lidhja e familjarëve mes tyre, statusi socio-ekonomik, besimi fetar apo diferencat gjinore, mund të jenë gjithashtu faktorë që i atribuohen ankthit (Jeynes 2002). Dykeman (2003) doli gjithashtu në përfundimin se shkalla e bashkëpunimit dhe frekuenca e konfliktit ndërmjet prindërve të veçuar apo të divorcuar ishin faktorë të rëndësishëm.

Nisur nga konteksti ynë kulturor si dhe bazuar në përfundimin se 69.2% e divorceve realizohen në situatë të fortë konfliktuale mes bashkëshortëve, vlerësohet se konflikti në familje është faktori kryesor i ankthit tek fëmijët e mitur.

Nga intervistat e thelluara individuale si dhe vëzhgimet e realizuara, u përcaktuan një sërë faktorësh të cilët rezultojnë të ndikojnë drejtëpërdrejtë mirëqënien psikologjike dhe ankthin tek fëmijët. Një pjesë e faktorëve që do të listohen më poshtë gjenden gjithashtu edhe në studimet e ndërmarra në vende të tjera mbi divorcin e ankthin.

Faktorët e listuar do të vijojnë nga ata me frekuencë më të shpeshtë tek çiftet në proces divorci me fëmijë të mitur në Shqipëri. Sjell në vëmendje se rëndësia e secilit prej tyre në përjetimin e ankthit është e barazvlefshme e nuk ka të bëjë me shpeshtësinë e frekuncës së hasur në popullatë.

1.	Episode të vazhdueshme dhune fizike dhe psiko-emocionale që përfshijnë edhe fëmijën/ët.
2.	Mungesë komunikimi mes prindërve.
3.	Alienim prindëror.
4.	Mjedis agresiv familjar për njërin prind.
5.	Qëndrimi i mjedisit social mbi divorcin.
6.	Zgjatje e procedurave për divorcin ligjor.
7.	Ndryshim i menjëhershëm i strukturës familjare.
8.	Fëmija/ët si përçues i mesazheve mes prindërve gjatë periudhës së divorcit ligjorë.
9.	Ndryshimi i ambientit social.
10.	Mungesë bashkëpunimi në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

Situata të tilla si: Mospranimi i divorcit nga njëri prind, pamundësia ekonomike për të jetuar të veçuar, apo në disa raste braktisja e fëmijës/ëve nga njëri prind për shkak se fëmija/ët del në krah të prindit tjetër, janë gjithashtu disa prej faktorëve që ndikojnë dukshëm gjendjen emocionale të fëmijëve të mitur dhe rrisin gjithashtu dukshëm riskun e përjetimit të ankthit. Gjithsesi mund të themi se mungesa e vëmendjes ndaj fëmijës/ëve është elementi që përmbledh shumë prej faktorëve të mësipërm që ndikojnë drejtëpërdrejtë në përjetimin e ankthit.

3. Cilat janë qëndrimet dhe sjelljet që prindërit në divorc duhet të mbajnë për të minimizuar nivelin e ankthit tek fëmijët e tyre?

Divorci është një traumë për të gjithë familjen që përfshihet në të. Shpesh partneri që merr vendimin për divorc ka përjetuar një sërë emocionesh negative, mund të ketë qenë viktimë e dhunës në familje, mund të ketë përjetuar neglizhimin dhe mund të jetë ndeshur me papërgjegjshmërinë e partnerit për familjen për një kohë të gjatë përpara vendimit për divorc. Kjo bën shpesh që konflikti të ketë arritur kulmin në momentin e procedurave ligjore për zgjidhje martesë.

Të ndodhur në një situatë të tillë, prindërit shpesh fokusojnë ndenjat dhe emocionet e tyre tek vetja e tek partneri. Në këtë periudhë ata janë shumë të okupuar me riorganizimin e mënyrës së jetesës, aspektin ekonomik si dhe shpesh me hakmarrjen ndaj partnerit. Të gjendur në këtë situatë ata shpesh nuk bëjnë pjesë të vendimit të tyre për divorc edhe fëmijët e mitur.

Fëmijët e këtyre prindërve gjenden në pjesën më të madhe të rasteve përpara faktit të divorcit dhe duhet të pranojnë apriori situatën ku ndodhen. Në disa raste, të painformuar rreth marrëdhënieve të prindërve, ata fantazojnë në një ribashkim të mundshëm të mamit e babit dhe fokusojnë energjitë e tyre mbi këtë gjë.

Ajo ç'ka u konstatua gjithashtu gjatë realizimit të studimit, është mungesa e vëmendjes së prindërve ndaj fëmijëve të mitur gjatë kësaj periudhe në lidhje me ecurinë në shkollë, frekuentimin e shoqërisë apo përjetimin e ndjenjave.

Duke marrë parasysh situatën në të cilën ndodhet e gjithë familja, riorganizimin e mënyrës së jetesës, por duke mbajtur parasysh mbi të gjitha interesin më të lartë të fëmijëve për minimizimin e ankthit dhe përjetimeve të tjera negative psikologjike, për prindërit në proces divorci rekomandohet:

Mos bëni fëmijën/ët pjesë të problemeve tuaja bashkëshortore duke i përfshirë në dhunën ndaj partnerit/es, debatet apo konfliktet e tjera në familje.

Shpjegojini me fjalë të thjeshta e të qarta situatën mes jush duke marrë parasysh moshën e tyre kognitive dhe kuptueshmërinë.

Bëjini pjesë të vendimit. Divorci është një situatë që përfshin ata njësoj si ju.

Shpjegojini se divorci nuk erdhi për shkak të tyre.

Shmangni alienimin prindëror.

Mos përdorni fëmijët si përcues të mesazheve mes jush. Shpesh fëmijët deformojnë fjalët e thëna nga ju për të mbrojtur njërin prind apo tjetrin.

Përpiquni të ruani sa më shumë rutinën e fëmijës tuaj edhe pas veçimit nga partneri. Kjo ndihmon dukshëm mirëqënien e tyre psiko-emocionale.

ini të vëmendshëm ndaj ecurisë së fëmijës/ve në

shkollë, frekuentimit të shoqërisë dhe ndryshimeve në humor dhe sjellje.

Shpenzoni sa më shumë kohë duke u angazhuar në aktivitete me to. Të qënit prezent fizikisht pa u angazhuar, nuk përkthehet detyrimisht në të qënit prind i mirë.

Kërkoni ndihmën e një specialist të fushës. Divorci është një traum që prek ju e të gjithë familjen.

PËRFUNDIME

Rezultatet tregojnë se ka një korrelacion të drejtë mes divorcit konfliktual dhe përjetimit të ankthit tek fëmijët. Një sërë faktorësh të tillë si: dhuna në familje, moskomunikimi mes prindërve, alienimi prindëror, etj. u listuan gjithashtu si ndikues negativ që rrisin përjetimin e ankthit tek fëmijët.

Ky studim i ndërmarrë duke përfutur shifra konkrete e duke nxjerrë në pah qëndrimet e sjelljet e vetë palëve në proces divorci, është inicie për studime të mëpasshme për të parë më thellë problemet psiko-emocionale që rrjedhin tek fëmijët si pasojë e divorcit. Njohja me problemin përbën një tregues të mirë për të ndërgjegjësuar prindërit dhe minimizuar përjetimin e ankthit e çregullimeve të tjera emocionale.

REKOMANDIME

Fillimisht rekomandohet realizimi i një studimi më të gjerë e përfaqësues për të vlerësuar më qartë marrëdhënien mes divorcit e përjetimit të ankthit tek fëmijët apo efekteve të tjera që ka veçanërisht procesi i divorcit në mirëqënien psiko-emocionale të tyre.

Së dyti, duhet të vlerësohet mundësia e studimit të mëtejshëm të faktorëve që ndikojnë përjetimin e ankthit tek fëmijët.

Së treti, rekomandohet që të eksplorohej strategji të tjera funksionale që do të ndihmojnë në ndërhyrjen e problemit.

BIBLIOGRAFIA

1. Dykeman, B.F. (2003). *The effects of family conflict on resolution on children's classroom*

behavior. Journal of Instructional Psychology, 30, 41-46

2. Jeynes, W. (2002). *Divorce, family structure, and the academic success of children*. Binghamnton, NY: Haworth Press, Inc.

3. Treska.V. (2011). *Tendencat e divorceve dhe shkaqet e tyre psikologjike tek çiftet shqiptarë*. Referuar në Konferencën e Prishtinës. Instituti Alb Shkenca.

4. Vandewater, E.A., & Landsford, J.F (1998). *Influence of family stucture and parantal conflict on childen's well-being*. Family Relations, 47, 321-328.

5. Yongmin, S. (2001). *Family environment and adolescents' well-being before and after parents' marital disruption: A longitudinal analysis*. Journal of Marrige & Family, 63, 697-711.